VENDIM
Nr. 207, datë 9.4.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, të shkronjës "h", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën "b", të pikës 1, të kreut I, shtohet emërtesa "Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve";

b) Pas pikës 28, të lidhjes nr. 3, shtohet pika 29, me këtë përmbajtje:

"29. Në Kancelarinë e Urdhrave dhe Medaljeve, nëpunësi në pozicionin "kancelar", në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj.";

c) Lidhja nr. 8 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2025, përballohen nga buxheti i miratuar për Kancelarinë e Urdhrave dhe Medaljeve për këtë vit dhe fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve/punonjësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 8

Klasat e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në institucionet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës, 1, të kreut I, të këtij vendimi

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës
Kancelar i Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve	I-1	1
Titullar i institucionit	I-2	1
Zëvendëstitullar i Agjencisë për Media dhe Informim; Zëvendëskancelar i Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve	I-3	1

Drejtor njësie në Departamentin e Administratës Publike	I-4	1
Zv./titullar i institucionit; Drejtor i drejtorive të përmbajtjes; Koordinator në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje; Koordinator në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës; Koordinator në Agjencinë për Media dhe Informim; Zëdhënës i ministrit; Koordinator në Autoritetin Kombëtare për Sigurinë Kibernetike; Ekspert në Kancelarinë e Urdhrave dhe Medaljeve.	II-1	1
Drejtor i drejtorive mbështetëse	II-2	1
Përgjegjës Sektori; Koordinator në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje; Koordinator në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës; Ndërmjetës në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje; Analist në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës; Ekspert në Kancelarinë e Urdhrave dhe Medaljeve;	III-1	1
Përgjegjës sektori; Koordinator në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje; Koordinator në njësitë organizative të përmbajtjes në Departamentin e Administratës Publike; Inspektor në Agjencinë e Prokurimit Publik.	III-2	1
Specialist	IV-1	1 ose 2
Specialist	IV-2	1 ose 2, ose 3
	IV-3	1 ose 2, ose 3